



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:145077

Datë: 08.11.2023

Numri i dokumentit: 04889644

P.nr.2416/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Penal, me gjyqtarin Ertan Sejfulla, me praktikanten Liberta Xhema, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.D, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269, paragrafi 2 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2544/23, të datës 19.06.2023, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, më datë 08.11.2023, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2544/23, të datës 19.06.2023 dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari: B.D, nga i ati, i lindur më datë, në, me vendbanim në Rrugën “.....”, në, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e: Më datë 24.01.2023, rreth orës 20:20, në Rrugën “.....” në, i akuzuari kur është ndaluar nga Policia e Kosovës dhe gjatë kontrollit fizik, ka poseduar pa autorizim substancën narkotike e cila sipas ekspertizës ka rezultuar të jetë e llojit kanabis/marihuanë, me përmbajtje Tetrahidrokanabinol, më peshë neto të përgjithshme 1.05 gram.

- me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269, paragrafi 2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69 të KPRK, si dhe neneve 364 dhe 495, të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit **B.D.** i shqipton **Dënim me Gjobë** në shumën **prej 200.00** (dyqind) €, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par 3 të KPRK-së, do ta zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.

I njëjti dënimin e shqiptuar mund të paguajë, me dy këste. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet, nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Obligohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet procedurale, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) €, si dhe për fondin e kompensimit të viktimave në shumën prej njëzetë (20) €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konfiskohet substanca narkotike e llojit Kanabis (Marihuanë) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë të përgjithshme prej 1.05 gram.

Urdhërohet Policia e Kosovës që substancën narkotike të konfiskuar ta shkatërroj sipas procedurave ligjore në fuqi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2544/23, të datës 19.06.2023, për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269, paragrafi 1 të KPRK-së, të cilin me parashtrësën për plotësimin e aktakuzës të dt.03.11.2023 ka përmirësuar kualifikimin juridik ashtu që duhet të jete Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269, paragrafi 2 të KPRK-së dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i akuzuari vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjykata pasi shqyrtoi përmbajtjen e aktakuzës me kërkesën për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor nga ana e organit të ndjekjes, gjeti se e njëjta është përpiluar në përputhje me nenin 493 të KPP-së, andaj erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet nga neni 495 i KPP-së, që

në këtë çështje penale pa u mbajtur fare shqyrtimi gjyqësor të marrë vendim për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor ndaj të pandehurës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë në bazë të: Raportit të testit laboratorik i dt.18.05.23, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, si dhe në bazë të dokumentacionit me shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se e pandehura është penalisht përgjegjëse për kryerjen e veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269, paragrafi 2 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Gjykata vlerëson se me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështirësi të nenit 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, që në të ardhmen i akuzuari të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngrit moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në bazë të Ligjit nr.08/L-109.

Vendimi për konfiskimin e mor në bazë të nenit 269 par.3 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 364 e 495, të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal

P.nr.2416/23, i datës 08.11.2023

Gjyqtari
Ertan Sejfulla

KËSHILLË JURIDIKE: I akuzuari ose mbrojtësi i tij, në afat prej tetë (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi-urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.